



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal

SHËNIM ZYRTAR NR.13/2019

Nga takimi i Komisionit me z.Janez Kopaç, drejtor i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, datë 12.2.2019, ora 13:00, Prishtinë

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal i Kuvendit të Kosovës, i kryesuar nga Sala Berisha Shala, kryetare e komisionit, priti në takim z.Janez Kopaç, drejtor i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, me seli në Vjenë. Në këtë takim u diskutua lidhur me gjendjen e zbatimit të legjislacionit të Komunitetit të Energjisë.

Kryetarja e komisionit, znj. Sala Berisha Shala, e falënderoi z. Kopaç për takimet e rregullta tashmë tradicionale që mbahen me komisionin, ku informohemi për më të rejat në Komunitetin e Energjisë. Ajo dha një pasqyrë të zhvillimeve, sa i përket legjislacionit në fushën e energjisë në Kosovë. Më tej, potencoi se komisioni e ka trajtuar me prioritet sektorin e energjisë. Ka miratuar Ligjin për efikasitet të energjisë dhe tashmë ka filluar së zbatuari. Për këtë vit kemi planifikuar të monitorojmë zbatimin e Ligjit për energjinë elektrike, mandej në një fazë të mëvonshme edhe Ligjin për efikasitet të energjisë. Ka iniciativa për prodhimin e energjisë me erë, ku një investitor është kualifikuar, si investitor strategjik, që pritet të investojë rreth 160 milionë euro në energjinë me erë. Po ashtu, kemi pasur disa herë raportim të ministrit të Zhvillimit Ekonomik, lidhur me energjinë. Ofrimi i përvojave më të mira të zhvillimit të sektorit energjetik nga Sekretariati është i mirëseardhur.

Z. Janez Kopaç, tha se ndjehet i lumtur të ndajë raportet e zbatimit të legjislacionit të Komunitetit të Energjisë me deputetët. Ai, në vazhdim, para deputetëve prezantoi kornizën aktuale ligjore të Komunitetit të Energjisë, për secilën kategori të energjisë, pikëpamjet e gjendjes së zbatimit të legjislacionit të Komunitetit të Energjisë për palët kontraktuese, gjendjen në energjinë elektrike. Ai foli edhe për termocentralin “Kosova e Re”, ku tha se çmimi i energjisë nga “Kosova e Re”, siç është paraparë, është 80 euro. Ky çmim nuk do të jetë konkurrues, sepse është 20 deri 30 euro më shtrenjtë sesa çmimi i tregut. Dhe duhet të subvencionohet, sepse nuk mund të eksportohet me atë çmim të lartë. Ai përmendi se Komuniteti i Energjisë ka edhe procedura ndëshkimore për shkelje nga anëtarët e Komunitetit të Energjisë. Ka raste të procedurave për shkelje nga Bosnjë dhe Hercegovina, Ukraina, Serbia, etj.

Dardan Sejdiu pyeti: Cilat janë shkeljet e Kosovës?

Janez Kopaç, u përgjigj se Kosova rrezikon të bëjë shkelje për ndihmën shtetërore, lidhur me termocentralin “Kosovën e Re” dhe nga direktiva për djegie, që lidhet me “Kosovën B”. KOSTT-i është në proces të certifikimit dhe me siguri do të certifikohet pas opinionit të Sekretariatit. Integrimi rajonal i tregut të energjisë elektrike të Kosovës, është në pritje të zgjidhjes së mosmarrëveshjes ndërmjet operatorit të sistemit të transmisionit të Kosovës dhe Serbisë.

Hykmete Bajrami, tha se ZRRE-ja ka licencuar disa furnizues, por që nuk punojnë, sepse nuk arrijnë të bëjnë furnizim të energjisë elektrike, për shkak të kontratave të komplikuara.

Janez Kopaç, theksoi se tregu duhet të jetë më likuid. Ai, në vazhdim, foli për naftën, ku theksoi se duhet të miratohet ligji për rezervat e obligueshme të naftës. Po ashtu, foli edhe për energjinë e ripërtëritshme, ku theksoi se Kosova është në trajektore të arrijë tragetin prej 25% të burimeve të energjisë së ripërtëritshme deri më 2020, në saje të rishikimit të përfshirjes së biomasës në statistikat energjetike. Ai theksoi se investimet në energji të ripërtëritshme, të bëhen përmes ankandëve, sepse arrihen çmime më të lira të energjisë elektrike. Përkrahja për energjinë e ripërtëritshme duhet të vazhdojë. Më tutje, ai foli për mjedisin, eficiencën e energjisë, klimën dhe ndihmën shtetërore, ku tha se Kosova qëndron shumë keq me ndihmën shtetërore, që ndërlihet me “Kosovën e Re”.

Dardan Sejdiu pyeti: A ka provuar dikush tjetër ankandet, përveç Shqipërisë? Si i trajton korniza ligjore kompanitë ESCO?

Janez Kopaç, tha se në Evropë aplikohen shumë ankandet, por në Austri nuk ka. Kompanitë ESCO nuk parashihen me direktivë. Serbia dhe Ukraina kanë ligj për kompanitë ESCO, Bosnja po ec mirë me ESCO-n, Maqedonia po ec ngadalë.

Hykmete Bajrami, theksoi se sa i përket rezervave shtetërore nuk kemi lëvizur përpara. Ideja për projektligjin e naftës, ka qenë që të preket edhe cilësia e naftës, edhe rezervat shtetërore. Ajo pyeti: a mund të komunikojmë me Sekretariatit dhe të kemi ekspertë nga Sekretariati, kur të na vijë projektligji për rezervat e obligueshme të naftës në Kuvend?

Janez Kopaç, u përgjigj dhe se është e mundur, duke shtuar se kemi ekspertin e naftës në Sekretariat, i cili është nga Shqipëria dhe do të jetë në dispozicion për t’ju ndihmuar. Me rezerva të naftës, Serbia është 19 %, Maqedonia është mirë, Shqipëria askund, Kosova askund, Mali i Zi askund.

Dardan Sejdiu, falënderoi z. Kopaç për ndarjen e informacioneve për gjendjen e energjisë në Komunitetin e Energjisë. Ai theksoi se lidhur me termocentralin “Kosova e Re” është me rëndësi të kemi një këndvështrim të Sekretariatit. Informacioni që po marrim nga Sekretariati po na edukon për trendet e zhvillimit të sektorit energjetik.

Janez Kopaç, theksoi se kemi një çështje të pazgjidhur mes KOSTT-in dhe ENTSO-E-në, që duhet të zgjidhet. Vitin e kaluar, në ENTSO-E rreth 50/50 janë pajtuar me shkrim. Shpresoj që vendimet e fundit janë presion shtesë ndaj Serbisë, që të reflektojnë. Kam kënaqësinë të ndajë me juve këndvështrimin tonë për çështjet që ndërlihen me termocentralin “Kosova e Re”.

Sala Berisha- Shala, tha se duhet që sa më parë të ndodhë hapja e tregut të energjisë në Kosovë. Projektligji për rezervat e obligueshme shtetërore të naftës, disa vite ka qenë në

agjendë të Qeverisë dhe nuk ka ardhur për shqyrtim në Kuvend dhe duhet të kërkojmë nga ministria ta procedojë më shpejt këtë projektligj. Duhet të angazhohemi që ligjet që krijojnë barriera t'i përmirësojmë në funksion të avancimit të energjisë së ripërtëritshme. Edhe në takimin e Shkupit, në nëntor 2018, u tha se palët që nuk respektojnë marrëveshjen, të ndëshkohen. Serbia, siç e dimë, nuk e respekton.

Si konkluzion i përbashkët në këtë takim ishte që të angazhohemi të ofrojmë energji më të lirë për qytetarët, në përputhje me zhvillimin e qëndrueshëm të energjisë dhe miqësor me mjedisin. Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacioneve me Sekretariatit të jetë i vazhdueshëm.

Përgatiti:

Njësia mbështetëse e komisionit.